




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 454 / Prot.

Tiranë, më 06 / 02 / 2025

Lënda: Dërgohet numri i miratuar i punonjësve për vitin 2025

Drejtorisë Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, _____
Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare, _____
Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare, _____
Institucionit Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe
Inovacionit, Tiranë


Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, bashkëlidhur kësaj shkrese ju dërgojmë shkresën nr. 1009/1 prot., datë 03.02.2025, të Ministrisë së Financave “Miratim e numrit të punonjësve për vitin 2025”, për institucionet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Gjithashtu theksojmë se në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, përcaktohet se: “Për vitin 2025 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore apo nivelet e klasave dhe shtesat mbi pagë me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përllogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve/funksioneve të reja. Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përllogaritur sipas gradave të miratuara”.

Për sa më sipër, kërkojmë nga drejtuesit e institucioneve arsimore, zbatimin me korrektesë të detyrimeve ligjore.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 1009/ 4 Prot.

Tiranë, më 3.02.2025

Lënda: Miratim i numrit të punonjësve, për vitin 2025.

DEGËS SË THESARIT _____

Për dijeni: MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT ✓

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025" si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 454 Prot., datë 20.01.2025, miratojmë detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2025, sipas strukturave në tabelën bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja
Besmir Beja




Tabela nr. 2 Numri miratuar i punonjesve per vitin 2025, miratuar me ligji nr.115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025"

19

Kodi Qeverisjes	Ministria e Linjes	Institucioni	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi I Qarkut	Output kod	Emertimi i Produktit	Numri miratuar i punonjesve per vitin 2025
001	11	1011237	Ajencia Kombetare e Kerkimit Shkencor dhe Inovacionit Tirane	01	09770	6000000	3535	91106AA	Nsitja e punes kerkimore ne IAL	19